



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT**

Nr. 1561/1 prot

Tiranë 05.10.2021

Lënda: Kthim përgjigje kërkesës tuaj për informacion

Qendra Respublica

Adresa: Blv "Gjergj Fishta" Nd. 24 H3 Ap 7

Tiranë

Referuar kërkesës tuaj për informacion, me nr. prot 136/21 protokolluar me tonën me nr. 1561 prot, datë 29.09.2021 ku ju kërkonte:

- Një kopje të Oponencës teknike të kryer nga Institutit i Ndërtimit në Pallatin nr. 3 Rruga Viktor Hygo, Njësia Administrative nr. 7 Tiranë
- Një kopje të preventivit të punimeve të hartuar për objektin e mësipërm,

Bashkëlidhur kësaj shkrese, do të gjeni kopje të oponencës teknike si dhe preventivin për objektin Pallati nr. 3, Rruga Viktor Hygo, Njësia administrative nr. 7 Tiranë.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

**Artan SHKRELI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT

Nr. 2678 / prot
5

Date 13 / 11 / 2020

Lënda: Dërgim përgjigje për Oponencën Teknike të akt ekspertizës së thelluar

BASHKISË TIRANË

Sheshi "Skënderbej" Nr.2, Tiranë

Në bazë të kërkesës suaj me Nr.38303 Prot, datë.03.11.2020, protokolluar me tonën me Nr.2678 Prot, datë.12.11.2020, "Kërkesë për kryerjen e Oponencës Teknike të akt ekspertizës së thelluar", Bazuar në Nenin 34, të Aktit Normativ Nr.9, datë.16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të objektit: "PALLATI Nr.3", RRUGA "VIKTOR HYGO", Nj. Adm.Nr.7, TIRANË, konkludojme se:

Akt ekspertiza e hartuar, nga shoqëria "INSTITUTI DEKLIADA - ALB", SHPK me Ing. Konst. Dhimitër PAPA, Ing. Niko NASKA, Ing. Alma DERAJ, Ing. Devis HASALAMI jep analizë të gjendjes ekzistuese, të dhëna mbi materialet e ndërtimit, të dhenat nga projekti i zbatimit, të dhëna gjeologjike dhe sizmike, prova laboratorike, dëmtimet, etj.

Sipas Akt ekspertizës objekti është një godinë me 2 kate mbi toke i rregullt në plan dhe i pa rregullt në vertikalisht, me sipërfaqe rreth 430 m² për kat dhe me lartësi të katit prej 2.90 m dhe me lartësi 2.80 m të katit të parë. Objekti është i organizuar në mënyrë gjatësore dhe përbehet me 2 shkallë cdo shkallë është e përbërë me 3 apartamente me sipërfaqe rreth 70 m².

Struktura e objektit është konceptuar dhe realizuar me konstrukcion mbajtes me murature tulle të kuqe me nderkate me trare dhe soleta betonarme. Në teresi, struktura e objektit përfaqësohet nga një sistem i përbërë, ku themelet janë realizuar me murature guri, elementet vertikale me murature tulle me breza beton arme, trare beton arme monolite, soletat b/a të tipit SAP.

Sipërfaqja totale është rreth 826.5 m². Themelet janë realizuar me rripa të kryqëzuar prej murature guri dhe butobeton, me thellësi të tabanit rreth 130cm referuar kuotës së tokës natyrore dhe rreth 1.95m referuar kuotës +0.00.

Materialet e ndërtimit nga provat rezultojnë me beton C16/20, çelik me fyk=25000N/mm², muratura me markë të tullës 75 dhe llac me markë 12. Niveli i njohjes është KL2. Koefficienti i sigurisë për këtë objekt është marrë 1.35 (Limited Knowledge).



Nga inspektimet dhe analizat e kryera vihet re qe termeti i dates 26.11.2019 ka lene pasoja dhe deme te konsiderueshme ne strukture. Objekti klasifikohet i shkalles se demtimit DS 4.

Pra Akt Ekspertiza ka dalë me konkluzionin që godina duhet të Riaftësohet/Përshtatet dhe përmirësohet sipas kushteve të reja sizmike dhe strukturale konform Eurokodeve.

Struktura është projektuar në bazë të kushteve shqiptare KTP dhe nuk i përgjigjet kërkesave te Eurokodeve, prandaj ka nevojë për tu përshtatur sipas tyre. Në akt ekspertizë jepen dhe tipet e ndërhyrjes në strukturë të cilat konsistojnë në riaftësim përshtatje/përmirësim i plotë strukturor i godinës sipas kërkesave sizmike dhe strukturale referuar Eurokodeve.

Në raportin e vlerësimit strukturor autorët shprehen:

Perfundimisht, mund te konkludojme, qe kjo ndertese ne gjendjen egzistuese i ploteson kushtet e sigurise dhe qendrueshmerise per ngarkesa statike por nuk i ploteson ato per ngarkesa dinamike sizmike, referuar gjendjes se pare kufitare si dhe kriteret e sherbimit ne ulje dhe deformime referuar gjendje se dyte kufitare (gjendjes kufitare te shfrytezimit) duke u bazuar ne Eurocode per aktivitet sizmik me $PGA = 0.270 g$.

Struktura e objektit ne gjendjen egzistuese nuk i ploteson kushtet e sigurise dhe qendrueshmerise per nje vend sizmik sic eshte Tirana dhe duhet ti nenshtrohet restaurimit dhe perfocimit, mbi bazen e specifikave teknike te projektit perkates bashkengjitur.

Rekomandojme qe struktura e mesiperme te perforcohet dhe te restaurohet konform projektit perkates. Rekomandime për ndërhyrjet strukturale të nevojshme për kthim të strukturës konform kushteve teknike dhe përshtatjen sipas standardeve shqiptare ose specifikimeve teknike dhe/ose standardeve të tjera të barasvlefshme.

Pra Akt Ekspertiza ka dalë me konkluzionin që godina duhet të Riaftësohet/Përshtatet dhe përmirësohet sipas kushteve të reja sizmike dhe strukturale konform Eurokodeve.

Në bazë të analizave të kryera autorët kanë dal në përfundimin që struktura të kthehet në standartet e sigurisë të kërkuara nga kodet e sotme Europiane të projektimit duhet ti nënshtrohet ndërhyrjeve përforcuese.

Në dokumentet e paraqitura për oponencë teknike është dhënë dhe projekti i perforceimeve i hartuar nga shoqëria INSTITUTI "DEKLIADA-ALB", shoqëruar me raportin teknik përkatës, metodologjine punimeve, raportin topografik.

Projekti i përforcimit konsiston në përforcimin e elementëve strukturore.

Struktura do te perforcohet duke nderhyre ne muret mbajtese me veshje me beton torcrete (me rezistence jo me pak se 40 MPa) dhe zgara celiku T 131 me diameter 5 mm/150 mm. Zgarat do te lidhen me shufra terthore me diameter 8 mm dhe do te vendosen ne te dyja faqet e mureve. Te dyja zgarat do te lidhen me shufra-fitila terthore te vendosura konform projektit konstruktiv.

Soletat, te realizuara me panele te parapregatitura do te perforcohen duke perdorur zgara te tipeve T 188 siper dhe T 92 poshte. Nga siper soletat do te vishen me beton C20/25 dhe nga poshte do te vishen me beton torcrete. Lidhja e te dyja shtresave do te behet me shufra terthore te cilat do te futen ne zonat e bashkimit te paneleve. Soletat gjithashtu do te lidhen me muraturen nepermjet shufrave te cilat do te inkastrohen ne faqen e jashtme te murit me ane te pillakave metalike.



Projekti i përforcimit është i detajuar dhe me shënimet e nevojshme teknike. Materialet që do të përdoren janë konform kushteve teknike. Mbi bazën e këtij projekti është hartuar dhe një preventiv me një vlerë të punimeve të përforcimit *22,560,186 lekë me tvsh* e cila duke e krahasuar me vlerën totale të ndërtimit të objektit nga e para për të njëjten sipërfaqe $= 826,5 \text{ m}^2 \times 32.113 \text{ leke/m}^2 = 26.541.394 \text{ leke}$, duke iu referuar kostove ndërtimore në treg për një sipërfaqe të njëjtë është më e madhe se 70 %, (85% % >70%).

Pra si përfundim mund të themi se Akt eksertiza e thelluar për objektin "PALLATI 3", Rruga "Viktor HYGO", Tirane është e detajuar dhe e bazuar në studime, prova laboratorike dhe analiza strukturore të plota.

Nga analiza e kësaj ekspertizë dhe vlerës së punimeve të rikonstruksionit dhe përforcimit, dalim si përfundim që "PALLATI 3", RRUGA "VIKTOR HYGO", TIRANË duhet të Priset dhe të Ndërtohet e Re.

Projekti i ndërtimit të pallatit të ri të hartohet konform Eurokodeve 8 për nivelin e performancës për rastin e efekteve sizmike.

Projekti të zbatohet konform Eurokodit 8-3. Projekti si dhe Punimet e zbatimit të kryhen nga shoqëri të licensuara, për këto lloj punimesh. Përgjegjësia për projektin është autoreve të projektit të Rindërtimit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ing.Agron Hysenlliu

ME URDHËR DHE DELEGIM
DREJTOR DREJTORIE
Ing.Valbona PONDE



PREVENTIVI I PUNIMEVE

Objekti: "PALLATI 3" Rruga "VIKTOR HYG0" Njesia Administrative Nr. 7, Bashkia TIRANE

Nr	Nr. AN	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlefia
I.						
		Punime dheu				
1	2.5	Germim e mbushje dheu me krah kategoria IV per themele, h = 1.5 - 2.0 m	m3	4.63	714	3,308
2	2.1/a	Germim dheu me krah e transport me k dore 10 m, kategoria IV	m3	57.42	930	53,402
3	2.26/a	Germim themele e plinta b=2m, ekskavator me goma, kova 0.25m3 shkartim aut	m3	61.14	222	13,573
4	2.37/2b	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 7.0 km	m3	62.75	431	27,046
		Shuma				97,329
II.						
		Punime te ndryshme dhe prishje				
1	2.426/4	Prishje solela b/a	m3	8.04	4,721	37,966
2	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	49.95	3,509	175,265
3	2.426/1	Prishje mur tullie me pastrim	m3	12.43	1,315	16,350
4	An.	Prishje suva ekzistuese jashte me pastrim	m2	631.51	210	132,618
5	An.	Prishje suva ekzistuese muri brenda me pastrim	m2	1002.60	154	154,401
6	An.	Prishje suva ekzistuese tavani brenda me pastrim	m2	571.67	194	110,904
7	An.	Punime cmonim dhe rimontim dyesh ekzistuese	m2	69.60	1,354	94,235
8	An.	Punime cmonim dhe rimontim dritaresh ekzistuese	m2	102.60	1,354	138,922
9	An2.405	Cmonim praqe dyer, dritare, shkalle, me plake graniti te arruar	m2	39.86	366	14,589
10	An2.324a	Prishje plintuse plake grez	m1	385.44	57	21,970
		Shuma				897,220
III.						
		Punime murature				
1	2.64/2	Mur me tullie plota ne lartesi deri 3m me llag perzier M-25 (ripurim)	m3	21.47	6,309	135,475
		Shuma				135,475
IV.						
		Punime tavani, suvatimi dhe veshje				
1	2.300	Suva solele h ~ 4 m me drejtes, me krah	m2	562.71	1,038	584,090
2	2.310	Suva brenda mur tullie H=4m, me drejtes me krah, llac I perzier M-25	m2	932.52	674	628,516
3	2.308/a	Suvatin me grafiato h > 4 m	m2	583.77	1,057	617,042
4	3.761/3	Torkretim me llac cemento 1: 2, t = 3.5 cm	m2	1361.78	1,930	2,628,235
		Shuma				4,457,883
V.						
		Punime betoni dhe b/arre				
1	2.122/1a	Solela te plota b/a C 20/25 t = 10 cm, h ~ 4m	m3	8.64	14,548	124,007
2	2.121/1	Brez b/a C 16/20, h ~ 8 m	m3	5.53	12,420	68,633
3	2.109/2	Themel e xokol betoni C - 12/15 (Perforcim)	m3	40.39	8,545	345,173
		Shuma				537,813
VI.						
		Punime hekur betoni				
1	3.290	F V hekur betoni ne b/arre Ø 3 ~ 5mm	ton	4.89	185,853	908,038
2	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	3.91	113,157	442,924
3	2.167	F V hekur betoni periodik Ø > 10 mm	ton	4.07	103,498	420,809
		Shuma				1,771,771
VII.						
		Punime skeletare dhe kallepi				
1	2.428	Skele metalike me tubo tavani - 4m	m2	141.62	136	19,260
2	2.431	Skele metalike me tubo fasade > 12m	m2	683.81	151	103,256

3	2.454	Kallëpe për soketa dhe breza b/a	m2	86.55	694	60,067
		Shuma				182,583
VIII.						
		Punime h/zolimi dhe tarraçe				
1	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k kaunane	m2	184.63	1,332	245,922
2	2.200	Shtrese lluster cimento 1:2, t = 80 - 150 mm	m2	151.63	343	52,008
3	2.196/b	Hidroizolim me një shtrese mapel për tualetë	m2	126.77	706	89,501
4	2.426/3	Prishje shtresa betoni (tarace)	m3	44.06	3,509	154,594
5	2.239/a	Shtrese termoizolues me polisterol t=10 cm	m2	107.42	2,658	285,519
6	2.203	Veshje koormize llamari me xingai	m2	10.31	1,432	14,761
7	2.206	Kasete shkarkimi me llamari me xingai	cope	2	1,043	2,528
8	2.523	Tub kanalizimi pvc Ø200 mm për drenazhime	ml	301.86	2,009	606,429
9	2.209	Tub shkarkimi vertikal me llamari me xingai Ø 100 mm	ml	15.57	693	10,793
		Shuma				1,462,055
IX.						
		PUNIME DYER DHE DRITARE				
1	2.375/1	F V dritare d/alumini plastike me dopio xham	m2	28.08	14,993	420,992
2	2.373/1	F V vetratë d/alumini plastike me dopio xham	m2	5.32	12,096	64,306
3	2.383/2	F V dyer te brendeshme druri importi cilësi e II-te	m2	48.85	19,011	928,718
4	2.386/1	F V dyer te brendeshme metalike te blinduara	m2	16.47	22,645	373,034
		Shuma				1,787,050
X.						
		Punime shtresash				
1	An2.264	Shtrese lluster gimento 1:2 t = 50 mm	m2	644.30	675	434,903
2	2.267/1	Shtrese me pllaka porcelanet importi	m2	498.55	2,753	1,372,514
3	An2.263/4	Shtrese betoni C 16/20 t = 40 mm	m2	32.75	587	19,225
4	2.268/a	Shtalle te jashtme montazhi mermeri	m2	4.04	5,037	20,367
5	2.288	Trotuar me pllaka granit me bojë pa borduren e betonit	m2	56.33	2,140	120,540
6	2.390	Bordura trotuari 20x35cm te parapergatitura	ml	47.86	1,038	49,683
7	2.326	Veshje me pllake majolike	m2	183.07	2,133	390,478
8	2.324/b	Plintuse grez importi, h = 10 cm	m2	387.65	325	125,986
9	2.268/a	Shtalle montazhi dhe praqje dyer dritare mermeri	m2	40.94	5,037	206,212
		Shuma				2,739,907
XI.						
		Punime bojatisje				
1	2.404	Bojë hidroplastike (brenda)	m2	754.47	174	131,277
2	2.404/1	Bojë hidroplastike importi cilësi e I-re (jashtë)	m2	329.72	431	142,108
		Shuma				273,386
XII.						
		Instalime elektrike				
		Instalime H/sanitare				
XIII.						
		Instalime për Ngrohje Ventili				
XIV.						
		Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri				
XV.						
		Punime sisteme te jashtme				
		Shuma punime ndertimi I - XVI	<i>lek</i>			18,252,577
		Shuma I				18,252,577
		Fond Rezerve 3%	<i>lek</i>			547,577
		Shuma II				18,800,155

		TVSH 20%		<i>lek</i>					3,760,031
			Shuma Totale	<i>lek</i>					22,560,186

* Shënim: Të gjithë vlerat e zëratve si edhe analizat e kontimeve të referohen Manualit 2 dhe 3 - Mars 2015 në fuqi.

Konst. Ing. Dhimiter PAPA Nr.Liq. K.1510/2